

VENDIM
Nr. 212, datë 9.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 220, DATË 12.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË
TATIMPAGUESVE DHE TË KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË PROCEDURËS
SË THJESHTËZUAR TË FISKALIZIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 1, e 27, pika 1, të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 220, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi;”;

b) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Kanë kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm”;”.

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi;”;

b) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Kanë kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm”;”.

II. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku